



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201501400/48

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave për trajtimin me dieta të disa punonjësve të policisë së IEVP Lezhë të komanduar me detyrë në vitin 2019 në Forcën Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

Tiranë

**IEVP LEZHË**

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me hetimin administrativ që kemi nisur në vitin 2019<sup>1</sup> lidhur me kompensimin e shpenzimeve të transportit për disa punonjës të IEVP Lezhë, të komanduar me detyrë në IEVP "Jordan Misja". Në vijim të hetimit tonë jemi interesuar edhe lidhur me përfitimin e dietave prej këtyre punonjësve.

Në funksion të hetimit kemi kërkuar fillimisht informacion në IEVP Lezhë me shkresën Nr.K2/G13-30 Prot., datë 17.10.2019. Në përgjigjen që kemi marrë

---

<sup>1</sup> Disa punonjës të policisë së IEVP Lezhë, gjatë kohës që ishin të komanduar me detyrë në IEVP "Jordan Misja", Tiranë janë ankuar para ndihmëskomisionerit të Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili ndodhej në këtë IEVP për të verifikuar ankesën e një të paraburgosuri. Hetimi i ankesës së paraqitur nga punonjësit e policisë së IEVP Lezhë ka zgjatur në kohë për shkak të përgjigjeve jo shteruese që kemi marrë, kërkesave tona të përsëritura për informacion dhe domosdoshmërisë për të marrë sqarime në IEVP Lezhë, nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Këta punonjës të policisë së IEVP Lezhë kanë qenë të interesuar në vijimësi për zgjidhjen e kësaj situate e duke mos u adresuar shqetësimet e tyre, kanë paraqitur ankesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.

nga ky institucion me shkresën Nr.5601 Prot., datë 22.01.2020 jemi vënë në dijeni se: në vitin 2019, disa punonjës janë komanduar në detyrë pranë IEVP “Jordan Misja” dhe Forcave Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Referuar dokumentacionit që na është vënë në dispozicion, komandimi i tyre është bërë përkatësisht sipas Urdhrave: Nr.9769, datë 09.10.2018; Nr.1264/1, datë 05.02.2019; Nr. 4318 Prot., datë 14.05.2019; dhe Nr.2825/1, datë 28.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Sipas shpjegimit të dhënë nga IEVP Lezhë (në shkresën e lartpërmendur), një pjesë e punonjësve janë me banim në Qarkun e Tiranës, por disa prej tyre banojnë në Fushë-Krujë, Laç, Lezhë, Rubik etj., për të cilët kërkohet një diferencim në mbulimin e shpenzimeve të transportit për çdo vendbanim të tyre të specifikuar sipas distancës. Me shkresën Nr.2398 Prot., datë 02.05.2019, IEVP Lezhë i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve shtimin e buxhetit në mënyrë që punonjësit të përfitonin shpenzimet e transportit.

Në vijim të hetimit jemi interesuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për t’u informuar nëse janë kompensuar për shpenzimet e transportit punonjësit e IEVP Lezhë të komanduar në detyrë në Tiranë në vitin 2019. Në përgjigjen që kemi marrë me shkresën Nr.10886/1 Prot., datë 19.11.2020 vihemi në dijeni se, punonjësit e komanduar nga Lezha në Tiranë nuk e kalojnë kufirin e parashikuar prej 50 km dhe si rezultat nuk përfitojnë dietë sipas VKM Nr.329, datë 20.04.2016 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që punojnë jashtë qendrës së punës*”. Për sa i përket transportit të punonjësve që lëvizin në distancën Lezhë-Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme është shprehur se pagesa bëhet duke administruar biletat e udhëtimit të dorëzuara nga vetë punonjësit.

Duke ju referuar kritereve të VKM Nr.329, datë 20.04.2016 dhe përgjigjeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP Lezhë, që në vlerësimin tonë nuk ishin shteruese, iu drejtuam sërish kësaj të fundit me shkresa të përsëritura<sup>2</sup>, ku ndër të tjera kërkuam të informohemi për sa vijon:

---

<sup>2</sup> Shkresat: Nr.K2/G13-29 Prot., datë 23.12.2020; K3/G13-30 Prot., datë 25.02.2021; Nr.K2/G13-31 Prot., datë 06.05.2021.

- Sa është llogaritur dieta për secilin prej punonjësve që janë komanduar në vitin 2019 pranë IEVP “Jordan Misja” dhe Forcave Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe referimin ligjor;
- Cila është pika e referimit për të matur distancën, që ka shërbyer për të vlerësuar nëse punonjësit e komanduar do të trajtohen me dietë - vendbanimi i punonjësve apo qendra e punës së tyre (IEVP Lezhë);
- Si matet distanca për të llogaritur trajtimin financiar që i takon punonjësit të komanduar në një vend tjetër pune;
- A janë administruar biletat e udhëtimit të punonjësive të policisë së burgjeve që janë komanduar me punë në Tiranë në vitin 2019.

Në përgjigje të këtyre pyetjeve, IEVP Lezhë na sqaron me shkresën Nr.717 Prot., datë 12.05.2021, ku jepen emrat e 6 punonjësve, të cilët duhet të përfitonin dietë ditore 500 lekë sipas VKM Nr.329, datë 20.04.2016, pasi nga vendi i punës (IEVP Lezhë) e deri në Tiranë, ku ata janë komanduar në vitin 2019, distanca është mbi 50 km, e llogaritur në bazë të tabelave të miratuara me VKM, e cila tregon saktësisht distancën për çdo vendbanim, por në shkresën e IEVP Lezhë nuk është cituar VKM-ja në fjalë. Për sa i përket kompensimit të kostos së transportit, nga verifikimet që ka kryer IEVP Lezhë rezulton se punonjësit e komanduar nuk kanë depozituar biletë udhëtimi.

Në datën 18.11.2021, kërkuam pranë IEVP Lezhë të informohemi se në cilin dokument është bazuar përlllogaritja e largësisë së këtij institucioni me Tiranën, për të kërkuar dhënien e dietave për punonjësit e policisë së komanduar në vitin 2019. Dokumenti që na u referua është Urdhri Nr.1950, datë 15.03.2013 i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas të cilit largësia e IEVP Lezhë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është 52 km.

Meqenëse mënyra e llogaritjes së largësive ishte thelbësore për verifikimin e këtij rasti, iu drejtua sërish Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me shkresë<sup>3</sup>, ku kërkuam të informohemi si llogaritet largësia nga vendbanimi dhe qendra e

---

<sup>3</sup> Shkresat: Nr.K2/G13-34 Prot., datë 19.11.2021; K2/G13-35 Prot., datë 02.02.2022; K2/G13-36 Prot., datë 02.04.2022; K2/G13-37 Prot., datë 16.06.2022.

punës e punonjësit që komandohet/transferohet me detyrë në një qendër tjetër pune për efekt të përfitimit të dietave dhe kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit.

Bashkëlidhur përgjigjes që kemi marrë me shkresën Nr.1286/2 Prot., datë 17.06.2022, na janë dërguar dy urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, konkretisht: Urdhri Nr.1950, datë 15.03.2013 *“Për pagesën e dietave të shërbimeve jashtë rrethit”* dhe Urdhri Nr.4588/1 Prot., datë 16.06.2016 *“Mbi përcaktimin e distancave kilometrike dhe tarifave të transportit të udhëtarëve për trajtimin financiar të shërbimeve të punonjësve të D.P.Burgjeve jashtë qendrës së punës”*.

Urdhrat e lartpërmendur, për sa i përket përcaktimit të distancave për efekt të trajtimit me dieta të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, referojnë në Urdhrin Nr.125, datë 26.12.2011 *“Për miratimin e hartave të azhornuara të rrjetit rrugor e kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë”* të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe në Memo-n e datës 06.03.2013 *“Mbi përcaktimin e saktë të distancave kilometrike nga D.P.Burgjeve nëpër IEVP”*, që grupi i punës i ngritur për këtë qëllim i ka paraqitur Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Referuar tabelës së distancave ndërmjet qyteteve të Shqipërisë të hartuar në vitin 2011 nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, largësia ndërmjet qytetit të Lezhës dhe Tiranës është 56 kilometra. Ndërkohë, në Urdhrin Nr.125, datë 26.12.2011, të cilit i bashkëlidhet kjo tabelë nuk sqarohet nëse llogaritja e largësive ndërmjet qyteteve është bërë nga qendra e tyre apo nga ndonjë pikë tjetër referimi. Lidhur me sqarimin e kësaj çështje kemi patur komunikim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe jemi në pritje të një përgjigje.

Ndërsa, sipas matjeve që ka bërë grupi i punës i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në vitin 2013, largësia ndërmjet IEVP Lezhë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është 52 kilometra.

Në vitin 2019, kur disa punonjës të policisë së IEVP Lezhë janë komanduar në detyrë pranë IEVP “Jordan Misja” dhe Forcave Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ka qenë në fuqi Ligji Nr.10 032, datë 11.12.2008 *“Për Policinë e Burgjeve”*. Në pikën 3, të nenit 22 të këtij Ligji parashikohet si vijon: *“Në rastet kur fjetja, transporti dhe ushqimi nuk i sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, punonjësi i komanduar përfiton dieta, sipas legjislacionit*

*në fuqi*". Sipas analizës së dokumentacionit të administruar nga ana jonë, punonjësve të policisë së IEVP Lezhë nuk u është siguruar ushqimi, fjetja apo transporti dhe sipas VKM Nr.329, datë 20.04.2016 "*Për trajtimin financiar të punonjësve që punojnë jashtë qendrës së punës*", disa prej tyre duhet të trajtoheshin me dieta.

Në pikën 2 të VKM Nr.329, datë 20.04.2016 parashikohet si vijon: "*Për shërbime në një largësi mbi 50 km jashtë qendrës së punës, kur punonjësi kthehet brenda ditës, trajtimi financiar i tij përfshin dietën ditore, në masën 500 (pesëqind) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni. Përrjashtohen nga ky rregull punonjësit që dërgohen me shërbime në një largësi mbi 50 km, jashtë qendrës së punës, dhe që zgjatin mbi tri ditë pune, në bazë të programit të miratuar nga titullari apo zyrtari përgjegjës që autorizon shërbimin, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi. Këta punonjës trajtohen sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij vendimi*".

Kjo VKM e lidh përfitimin e dietës dhe kompensimin e shpenzimeve të transportit me largësinë ndërmjet qendrës së punës dhe vendit ku punonjësi dërgohet të kryejë shërbimin përkohësisht. Largësia ndërmjet IEVP Lezhë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e matur nga grupi i punës në vitin 2013 është 52 kilometra<sup>4</sup>. Pra, sipas këtyre përllogaritjeve punonjësit e policisë të komanduar me detyrë në Forcën Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve duhej të përfitonin dieta sipas pikës 2 të VKM Nr.329, datë 20.04.2016.

Punonjësit e policisë së IEVP Lezhë të komanduar me detyrë në Forcën Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë të caktuar në mënyrë nominale në Urdhrin Nr.9769, datë 09.10.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe në Urdhrin Nr.815, datë 06.02.2019 të Drejtorit të IEVP Lezhë (bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni fotokopje të këtyre dy urdhrave).

Në përfundim të analizës së këtij rasti çmujmë se nga ana juaj duhet të merren masat e nevojshme për të bërë përllogaritjen e kohëzgjatjes së komandimit në vitin 2018-2019, në Forcën Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të

---

<sup>4</sup> Sipas Memos të datës 06.03.2013 "*Mbi përcaktimin e saktë të distancave kilometrike nga D.P.Burgjeve nëpër IEVP*".

Burgjeve, të disa punonjësve të policisë së IEVP Lezhë dhe trajtimin e tyre me dieta, në përputhje me kuadrin ligjor.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*".

### **REKOMANDOJMË:**

- Marrjen e masave të nevojshme për përlllogaritjen konkrete dhe trajtimin me dieta të disa punonjësve të policisë së IEVP Lezhë të komanduar me detyrë në vitin 2019 në Forcën Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**